

Vendim nr. 71 datë 05.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 05.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “TURGUT OZAL EDUCATION” SH.A.,
përfaqësuar nga avokat Isuf Shehu.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3849, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Turgut Ozal Education” sh.a. (*kërkuesja*) është shoqëri aksionare me objekt veprimtarie, ndër të tjera, edhe hapjen e institucioneve parashkollore, çerdhe, kopshte etj. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (*Ministria e Arsimit*), me urdhrin nr. 67, datë 15.10.1998, ka miratuar lejen për funksionimin e institucionit privat të ciklit parashkollor, kopshti “Zybeyde Hanim” (*kopshti*), me adresë Rruga e Kavajës, nr. 185/6, Tiranë. Në vijim, në datën 13.07.2020, Ministria e Arsimit ka miratuar kërkesën e kërkueses për zhvendosjen e kopshtit (pjesërisht) në adresën rruga “Pavarësia”, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Kashar, Tiranë.

2. Përmes raportit të monitorimit të datës 28.01.2022, ndër të tjera, Zyra Vendore Arsimore Tiranë i ka rekomanduar kërkueses t’i kërkonte Ministrisë së Arsimit miratimin e ndryshimit të vendndodhjes së kopshtit, duke qenë se ai sipas licencës ndodhej në Rrugën e Kavajës, ndërkohë që në fakt ndodhej në rrugën “Bernard Palja”. Kërkuesja ka parashtruar një kërkesë të tillë, për të cilën, me shkresën e datës 12.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar pranë Ministrisë së Arsimit (*DPAP*) i ka njoftuar asaj raportin e vlerësimit, nëpërmjet të cilit i kërkohej plotësimi i rekomandimit për ndryshimin e vendndodhjes 3 (tre) muaj përpara fillimit të vitit shkollor 2022-2023, duke e paralajmëruar se në rast të mosmiratimit të vendndodhjes do të kërkohej pezullimi i aktivitetit deri në heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Në datën 08.06.2022 kërkuesja i është drejtuar përsëri Ministrisë së Arsimit për miratimin e vendndodhjes së kopshtit. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka verifikuar gjendjen fizike të objektit sipas relacionit të datës 21.06.2022, duke konkluduar se objekti i kopshtit nuk i plotësonte të gjitha kriteret e udhëzimit të ministrit të Arsimit nr. 15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, të ndryshuar (*udhëzimi nr. 15/2013*).

4. Në datën 03.08.2022 kërkuesja i është drejtuar sërish Ministrisë së Arsimit për vlerësimin e objektit të kopshtit, duke i bashkëlidhur edhe kërkesën e mëparshme për miratimin e ndryshimit të vendndodhjes së tij. Me shkresën e datës 13.09.2022, Ministria e Arsimit ka informuar kërkuesen për mosmiratimin e kërkesës për ndryshimin e vendndodhjes së kopshtit për shkak se objekti nuk i plotësonte të gjitha standardet e përcaktuara në udhëzimin nr.15/2013 dhe se objekti nuk ishte i pajisur me akt higjienosanitar.

5. Në vijim, mbështetur në raportin e vlerësimit të DPAP-së për kriteret e licencimit të kopshtit “Zubeyde Hanim”, Tiranë dhe propozimin e saj për heqjen e licencës për ushtrimin e

veprimtarisë së këtij kopshti, ministri i Arsimit ka nxjerrë urdhrin nr. 540, datë 15.09.2022 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshtit “Zubeyde Hanim”, Tiranë” (urdhri nr. 540/2022).

6. Me kërkesën e datës 20.09.2022 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me një kërkesë për sigurimin e padisë nëpërmjet marrjes së masës së pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, të urdhrin nr. 540/2022 të ministrit të Arsimit.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 26.09.2022 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuësjes për sigurimin e padisë, duke arsyetuar se për marrjen ose jo të masës së sigurimit të padisë ajo nuk mbështetet në fakte ose veprime që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes, sikundër as në pretendimet e palëve për themelin e mosmarrëveshjes. Sipas asaj gjykate, kërkuësja nuk ka provuar ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm, të bazuar në prova me shpresë, për mundësinë e shkakimit asaj të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm, çka të justifikonte marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të aktit administrativ. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka ushtruar ankim, kurse personi i tretë, Ministria e Arsimit, ka paraqitur kundërankim.

8. Me vendimin nr. 17, datë 27.02.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, duke arsyetuar në të njëjtën linjë si kjo e fundit se nuk provohet për kërkuësen ekzistenca e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshem. Edhe kundër këtij vendimi kërkuësja ka ushtruar rekurs të veçantë, ndërkohë që personi i tretë, Ministria e Arsimit, ka paraqitur kundërrekurs.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-3849, datë 12.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuësjes, me arsyetimin se kjo e fundit ka humbur të drejtën e rekursit për shkak se ai është paraqitur jashtë afatit të prerë 5-ditor, të parashikuar në nenin 443 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i cili gjente zbatim në atë rast sipas përcaktimit të bërë në nenin 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

10. Në datën 08.02.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuësjes

11. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit formal dhe substancial*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses me argumentin se është depozituar jashtë afatit 5-ditor, duke mos e shqyrtuar atë dhe duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të saj. Gjykata e Lartë, në pakujdesi, keqinformim ose në mënyrë të qëllimshme nuk i është referuar si datë e marrjes dijeni të vendimit të gjykatës së apelit, datës kur shërbimi postar e ka dorëzuar atë fizikisht, në adresën e kërkueses, që është data 27.03.2023, nga e nesërmja e së cilës ka filluar afati 5-ditor i rekursit të veçantë. Ai është depozituar nga kërkuesja në datën 03.04.2023 (ditë e hënë), në rrethanat kur data 01.04.2023 ka qenë ditë pushimi (e shtunë). Në supozimin se afati i paraqitjes së rekursit është një e metë që nuk është konstatuar nga gjykata e apelit, në respektim të nenit 60/1 të ligjit nr. 49/2012, relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë duhet t'i jepte mundësi kërkueses për të dhënë sqarime në këtë drejtim. Të njëjtën gjë duhet të bënte Gjykata e Lartë, në zbatim të nenit 473/a të KPC-së, edhe në supozimin që depozitimi i rekursit konsiderohet një çështje ligji, përderisa në rekurs dhe kundërrkurs palët nuk kanë paraqitur ndonjë mendim, pretendim ose argument në këtë drejtim. Duke vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkueses të drejtën për të vënë në lëvizje atë gjykatë, sikundër edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Gjykata e Lartë, në zbatim të parimit *iura novit curia*, duhet të vlerësonte dhe të analizonte pretendimet e ngritura nga kërkuesja në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë, duke qenë se cenimi i saj ndikon edhe në elemente të tjera të procesit të rregullt.

11.2. *Së drejtës së mbrojtjes efektive*, pasi kërkueses nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e saj për çështjen e afatit ligjor të analizuar nga Gjykata e Lartë, duke u vendosur në pamundësi për t'u mbrojtur efektivisht dhe duke u përballur me një vendim gjyqësor që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimeve që ajo kishte.

11.3. *Cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërisë legjitime*, pasi kërkueses nuk i është dhënë mundësia për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore për një

çështje që lidhej me të drejtat dhe interesat e ligjshëm të saj ose për të paraqitur pretendimet e veta me shkrim për ato çështje të ngritura kryesisht nga Gjykata e Lartë, në mënyrë që të realizonte një mbrojtje efektive. Pritshmëria e ligjshme e kërkueses ka qenë shqyrtimi i shkaqeve të rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe shmangia nga praktika e Kolegjeve të Bashkuara.

11.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja pa analizuar dhe dhënë arsye se përse ka kaluar afati i rekursit, pa shqyrtuar datën kur ajo ka marrë dijëni realisht për vendimin e gjykatës së apelit. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekursin e kërkueses, siç është ai i lirisë së veprimtarisë ekonomike. Në pamundësi për t'u mbrojtur, kërkuësja është përballur me një vendim gjyqësor të paplotë, alogjik dhe që nuk i jep përgjigje përfundimtare pretendimeve të saj për sa ka kërkuar në rekurs.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Kolegji vëren se objekt i ankimit kushtetues individual, në rastin konkret, janë vendimet gjyqësore që kanë vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses për sigurimin e padisë nëpërmjet marrjes së masës së pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, urdhrit nr. 540/2022 të ministrit të Arsimit.

14. Gjykata, gjatë shqyrtimit të ankimeve kushtetuese individuale, ndalet rast pas rasti në vlerësimin nëse për shkak të natyrës së veçantë të çështjes që shtrohet përpara saj për shqyrtim ka vend për përjashtim nga rregulli i natyrës përfundimtare të vendimit objekt i ankimit kushtetues individual, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Sipas saj, vendimet e ndërmjetme mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues në rast se plotësohen këto kushte: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta janë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë *(shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në lidhje me vendimet gjyqësore për marrjen e masës së sigurimit të padisë, Gjykata ka vlerësuar se ato, edhe në rast se pranojnë një kërkesë të tillë, nuk janë përfundimtare në lidhje me të drejtat themelore të individit, për sa kohë janë masa të përkohshme të marra gjatë procedurës së themelit të çështjes dhe nuk konsiderohen si një procedurë e veçantë, e ndarë nga ajo kryesore *(shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për më tepër, palët ndërgjyqëse, sipas rregullave procedurale, kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen ndërmjet tyre, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, derisa vendimi të bëhet përfundimtar, me kërkesa të reja për sigurimin e padisë, nëse ajo është refuzuar nga gjykata, por edhe me kërkesa për ndryshimin ose zëvendësimin e masës, kur gjykata e ka pranuar një gjë të tillë.

16. Në rastin konkret, edhe pse masa e përkohshme e pezullimit të zbatimit të aktit administrativ është bërë objekt i ankimit të veçantë (procesi objekt shqyrtimi), gjykatat nuk janë shprehur për ligjshmërinë ose jo të aktit administrativ dhe as për të drejtën substanciale që pretendohet se është cenuar, ndërkohë që ligjshmëria ose jo e urdhrit për mbylljen e veprimtarisë së kopshtit të kërkueses është objekt i një tjetër procesi gjyqësor, i cili do të vendosë për themelin e mosmarrëveshjes mes palëve. Kolegji vlerëson se procesi gjyqësor i vënë në lëvizje nga kërkesja, i përmbyllur me vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, nuk ka natyrë

përfundimtare, pasi jo vetëm që nuk vendos për të drejtat substanciale të saj, por, nga ana tjetër, as nuk është arritur të provohet se vendimi përfundimtar në lidhje me themelin e çështjes nuk do të ishte i aftë të ndryshonte ose riparonte efektet/pasojat e ardhura nga vendimet e kundërshtuara. Në këto kushte, për nga natyra e tij, procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkesja nuk është i tillë që mund të përfshihet në mënyrë përjashtimore në juridiksionin e kësaj Gjykate, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

17. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.